



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 341, Datë 14.11.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E  
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “ALPIQ  
ENERGY ALBANIA” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 5, gërma “ç”; 6 dhe 7 të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; pikës 5.1, gërma “ç”, të Kushteve të licencës së tregtimi të energjisë elektrike, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2311/1 prot., datë 09.11.2023, të përgatitur nga Grupi i Punës “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2023 të pashlyerja ndaj ERE-s”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ALPIQ ENERGY ALBANIA” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 290, seria T15/T20, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.05.2015, rinovuar me vendimin nr. 81, datë 04.05.2020.
- Me vendimin e bordit nr. 171, datë 15.05.2023, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2023 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.
- Vendimi i bordit të ERE-s sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 81, datë 29.05.2023. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1450 prot., datë 24.05.2023. Po ashtu, shoqërisë i është njoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1450/1 prot., datë 31.08.2023. Duke qenë se kjo shkresë është kthyer mbrapsht në institucion nga shërbimi postar, i është dërguar e skanuar shoqërisë me e-mail më 07.09.2023. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me Urdhrin e Kryetarit nr. 94, datë 18.10.2023 është ngritur Grupi i Punës për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2023, të pashlyera ndaj ERE-s.
- Rezulton se i licencuari “ALPIQ ENERGY ALBANIA” sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171/2023, dhe nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion mbi moshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2023, ndaj grupi i punës ka konstatuar se ky i licencuar ka kryer shkeljen si vijon:  
*Mos shlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2023.*
- Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se, *për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në gërmën ç) të nenit 42 parashikon se, ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.*
- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe ne bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitorë ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2023, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.
- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s për të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2023) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, gërma “ç” dhe nenit 6 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017.
- Neni 6 i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.04.2017, parashikon se *në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.*

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 290, seria T15/T20, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “ALPIQ ENERGY ALBANIA” sh.p.k.
2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.
3. Grupi i Punës të njoftojë shoqërinë “ALPIQ ENERGY ALBANIA” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**